

LIGJ

Nr. 25/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 352, DATË 18.11.2010, "PËR ARTIN DHE KULTURËN"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 5, pika 3, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "ç" shfuqizohet.
2. Shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:
"e)Teatri kombëtar eksperimental "Kujtim Spahivogli";".

Neni 2

Neni 14 shfuqizohet.

Neni 3

Kreu IV, "Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës", shfuqizohet.

Neni 4

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

Neni 26 - Financimi i projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore

1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, financon:

- a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën;
- b) projekte dhe veprimtari artistike e kulturore, të cilat konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte.

2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

3. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve artistike, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 5

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

Neni 27 - Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore

1. Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore për artin dhe kulturën bëhet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e kolegjiut, të përbërë nga:

a) personalitete të gjinive të ndryshme të artit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b) nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 26, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën."

Neni 6

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

Neni 27/1 - Kompetencat e kolegjiut

1. Kolegjiuti ka këto kompetenca:

a) përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave artistike, kulturore, edukative sociale dhe ekonomike;

b) miraton veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji;

c) nxit krijimtarinë artistike kombëtare dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën organizimin e konkurseve kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit.

2. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën."

Neni 7

Kreu VII, "Subjektet private të artit dhe kulturës", shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 34, pika 2 ndryshohet si më poshtë: "2. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në zbatim të politikave të saj, organizon konkurse kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit. Kushtet dhe masa e shpërblimit të fituesit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën."

Neni 9

Dispozita kalimtare dhe të fundit
Aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Miratuar në datën 20.3.2014
Shpallur me dekretin nr. 8531, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani.